

Lëvizja Vetëvendosje dhe serbët e Kosovës, një marrëdhënie e parehatshme

Hyrje

Lëvizja Vetëvendosje (VV) dhe serbët e Kosovës kanë pasur një marrëdhënie të ndërlikuar. VV-ja pretendon se Beogradi është fajtor, duke thënë se veprimet e saj janë të drejtuara kundër Beogradit dhe qeverisë së Kosovës, e jo kundër serbëve të Kosovës. Serbët e Kosovës thonë se shumë qëndrime të Beogradit, përfshirë Asociacionin/Komunitetin e komunave me shumicë serbe, reflektojnë interesat e tyre. Si rrjedhojë, nëse je kundër Beogradit dhe Asociacionit/Komunitetit, je edhe kundër serbëve të Kosovës. Sipas shumë serbëve, interesat e Beogradit dhe të serbëve të Kosovës janë të njejtat në të shumtën e rasteve. Përgjigja e VV-së ka qenë se nëse është kështu, atëherë serbët e Kosovës duhet t'i definojnë dhe prezantojnë vetë interesat e tyre. Nëse propozimi për Asociacionin/Komunitetin do të kishte ardhur drejtpërdrejt nga serbët e Kosovës, qasja e VV-së do të ishte ndryshe. VV-ja do ta diskutonte vlerën e saj me serbët e Kosovës. Mirëpo kur propozimet vijnë nga Beogradi, VV-ja i refuzon krejtësisht. Problemi i VV-së është më shumë me parashtruesin e kërkesës, Beogradin, sesa me kërkesen, që në këtë rast është Asociacioni/Komuniteti.

Thelbi i sistemit të tanishëm politik përbëhet nga ofrimi i favoreve politike dhe përfitimeve ekonomike, e jo nga ideologjia.¹ Partitë mirëmbajnë dhe fuqizojnë pushtetin e tyre duke u bërë

¹ Edhe pse partitë e Kosovës thonë se përfaqësojnë ideologji liberale (të majta) dhe konzervative (të djathta), dallimi mes tyre në praktikë është i mjegullt. Sa i përket taksave, VV-ja është në favor të taksës progressive--taksa më të ulëta për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, dhe taksa më të larta për korporatat dhe të pasurit. Partitë tjera nuk kanë qëndrime të qarta. Sa i përket çështjeve shoqërore, të gjitha partitë janë pothuasje të njejtat. Përveç presidentit, asnjë zyrtar tjetër i lartë apo udhëheqës partiak nuk ka marrë pjesë në LGBT paradën e organizuar në Prishtinë. Ata poashtu kanë qëndrime pothuajse të ngjajshme sa i përket fesë dhe abortit. Sa i përket klasës punëtore, ata poashtu nuk kanë ndonjë dallim. Asnjë parti nuk ka ndonjë qëndrim në lidhje me pagën minimale dhe që të gjitha përkrahin të drejta të fuqishme të punëtorëve, por në praktikë nuk i marrin parasysh shkeljet masive të këtyre të drejtave nga ana e kompanive. Sa i përket tregtisë, përveç VV-së e cila është në favor të disa kufizimeve me qëllim të mbrojtjes së prodhuesve vendorë, partitë tjera përkrahin tregtinë e lirë, edhe pse nuk ofrojnë arsye për këtë qëndrim--a e bëjnë këtë për të mbajtur çmimet e ulëta apo për arsye tjera. VV-ja poashtu është kundër privatizimit të asetëve kryesore nacionale, siç janë aeroportet, energjia dhe telekomunikacioni, kurse partitë tjera e mbështesin këtë privatizim. Në lidhje me shëndetësinë dhe arsimin, të gjitha partitë përkrahin sistemin e financuar nga qeveria, sistem ky i cili ofron kujdes shëndetësor të përballueshëm dhe shkollim për të gjithë. Sa i përket programeve sociale, të gjitha partitë kanë të njejtin mendim, sipas të gjitha gjasave për arsye politike. Te gjitha partitë përkrahin programe masive të mirëqenies, përfshirë pensionet për një numër shumë të madh të veteranëve të luftës, 47000 në total, dhe të gjitha flasin vetëm

favore militantëve të tyre dhe oligarkëve. Ata përkrahin vazhdimin e këtij sistemi sepse ai u lejon qasje të pakufizuar në pasurinë nacionale dhe ua mundëson drejtimin e shtetit pa kurrfarë kontrolli. Vetëm një shoqëri e fuqishme politike e ekonomike do të mund t'i minonte elitat e korruptuara, ta reformonte sistemin, dhe ta vendoste Kosovën në rrugë të pakthyeshme të konsolidimit demokratik. Por, reformimi i një sistemi të zhytur në korrupsion nuk është detyrë e lehtë.

Këto janë disa nga konkludimet e tryezës së rrumbullakët mbi marrëdhëniet mes VV-së dhe serbëve të Kosovë të organizuar nga Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) në qershor të vitit 2016 në Prishtinë, ku të ftuar kanë qenë një numër përfaqësuesish të VV-së dhe anëtarë të shoqërisë civile të serbëve të Kosovës.

Tryeza e rrumbullakët është pjesë e një projekti më të gjërë mbi marrëdhëniet mes shqiptarëve e serbëve në Kosovë, të financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës, dhe të implementuar në bashkëpunim me ta.

Ky raport bazohet tërësisht në diskutimet e tryezës së rrumbullakët dhe në takimet individuale disa pjesëmarrës. Diskutimet janë mbajtur në bazë të rregullave të Chatham House. Ne jemi munduar të jemi sa më të saktë dhe të balancuar në përmbledhjen e diskutimeve, dhe së këndejmi, kërkojmë mirëkuptim nga ana e pjesëmarrësve, kontributi i të cilëve mund të mos jetë pasqyruar tërësisht në këtë raport të shkurtër. Nënkryetari i CIG, Shpëtim Gashi e ka përgatitur raportin, dhe CIG merr përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e tij.

Nuk ka integrim pa “çlirim”

Politikanët shqiptarë e serbë e kanë integruar veten e tyre në mënyrë shumë të suksesshme, kanë fituar pasuri dhe fuqi politike, si dhe kanë marrur përkrahjen e komunitetit ndërkombëtar si garantues të paqes dhe stabilitetit, derisa shoqëria mbetet e dezintegruar, masovikisht e papunë, politikisht e dobët, dhe e ndarë në vija etnike.² Shumë folës kanë thënë se politikanët ndonjëherë bëjnë deklaratat “patriotike” për t'i “siguruar” votuesit se ata brengosen për interesat kombëtare. Por larg syrit të publikut, politikanët shqiptarë e serbë kanë raporte mjaft të mira, duke bërë biznes me njëri tjetrin dhe duke u pasuruar. Ata trokasin në dyert e votuesve vetëm disa ditë para zgjedhjeve për ta “rikonformuar” legjitimitetin e tyre. Disa pjesëmarrës kanë thënë se shoqëria

kalimthi në lidhje me nevojën për kontroll më të rreptë apo për uljen e financimit për këto programe. Vetëm pensionet për veteranët e luftës përbëjnë rreth 10 përqind të buxhetit të Kosovës. Ideologjikisht, ata të cilët deklarojnë se janë konzervativë, siç janë PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja, do të duhej të ishin fuqishëm kundër alokimit të 10 përqind të buxhetit për një program të vetëm social. Në anën tjetër, VV-ja do të duhej të kërkonte një mbikqyrje më efikase. Sa i përket punëve të jashtme, nuk ka dallime, përveç se çfarë lloji të marrëdhënieve do të duhej të kishte Kosova me Serbinë. Në lidhje me ambientin, nuk ka dallime të qarta. Asnjë parti nuk ka politika specifike për rregullimin e lumenjëve dhe pyjeve që janë degraduar pas luftës, e as për pastrimin e mijëra deponive ilegale të mbeturinave, të cilat sipas ekspertëve të mjedisit tashmë janë emergjencë nacionale. Partitë e serbëve të Kosovës deri më tani janë marrë ekskluzivisht vetëm me çështjet e serbëve.

² Një numër i pjesëmarrësve kanë thënë se parlamenti dhe qeveria e Kosovës kanë një numër të madh të milionerëve, dhe shumicën e anëtarëve mjaft të pasur. Kosova është vendi më i varfër në Evropë.

voton, por ajo nuk është e përfshirë në politikëbërje. “Shoqëria është thjesht një spektatore”. As serbët e as shqiptarët nuk janë të integruar në sistem. Shumë nga pjesëmarrësit kanë thënë se vetëm militantët partiakë dhe përkrahësit e zjarrtë mund të gjejnë punë. Duke iu përgjigjur brengave të njërit nga pjesëmarrësit serbë në lidhje me numrin e ulët të serbëve të punësuar në ndërmarrjet publike, njëri nga pjesëmarrësit është pajtuar se një numër shumë i vogël i serbëve janë të punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës apo në Postën dhe Telekomin e Kosovës, por ka shtuar se edhe numri i shqiptarëve të punësuar në këto ndërmarrje të cilët nuk janë të lidhur me partitë politike kryesore është shumë i vogël. Pjesëmarrësit kanë përmendur televizionin publik të Kosovës si njërin nga punëdhënësit më të mëdhenj “politik”, i cili shërbimin e vetëm publik të cilin e ofron është “prodhimi i lajmeve të këqija”. Sektori publik punëson më shumë se 80,000 njerëz. Për të mbajtur vendet e punës, njerëzit duhet të votojnë për partinë e cila i ka punësuar ata. Në thelb, serbët e shqiptarët ballafaqohen me të njëjtin problem: kapja e institucioneve nga politikanët e tyre. Ata nuk kanë nevojë vetëm për një integrim ndëretnik, por për një proces të çlirimit politik e ekonomik, pa të cilin nuk mund të ketë integrim ndëretnik.

Si mund të jetë i mundshëm ky “çlirim”? Kosova ka nevojë për prokurorë dhe gjykatës të guximshëm të cilët mund të merren me të pasurit dhe të fuqishmit. Sistemi ekzistues nuk është në gjendje të marrë një përgjegjësi të tillë. Ai është i dobët, joprofesional, dhe i kontrolluar nga politikanët. Vetëm trysnia masive e publikut, përfshirë protestat në rrugë, do të mund të sillnin një ndryshim të tillë. Disa pjesëmarrës u kanë bërë thirrje serbëve t’u bashkohen shqiptarëve në këtë përpjekje, përfshirë edhe pjesëmarrjen në protestat në sheshet e Prishtinës. Shoqëria duhet të marrë rolin udhëheqës në ndryshimet politike dhe “ti shëndrrojë politikanët në spektatorë, e jo t’u shërbejë atyre si makinë votimi”.

Shumë nga pjesëmarrësit kanë thënë se politikanët kontrollojnë edhe sektorin privat, i cili nuk mbështetet aq shumë në prodhim, por në qasjen e privilegjuar në pasurinë publike. Liberalizimi ekonomik është shtyer vetëm deri në atë pikë ku është mundësuar privatizimi i aseteve publike, të cilat në pjesën më të madhe janë “blerë” nga ata të cilët udhëheqin me shtetin, apo nga miqtë e tyre biznesmenë. Disa thonë se individët e fuqishëm politik e ekonomik “bashkohen” me qëllim të mbrojtjes së qasjes që kanë në pasurinë nacionale dhe drejtimit të shtetit pa kurrfarë kontrolli. Ky bashkim minon miratimin e reformave të cilat do t’i dobësonin monopolet, dhe do t’i përmirësonin çrregullimet e tregut të cilat për momentin ofrojnë privilegje për individët e fuqishëm dhe ndërmarrjet, duke impnuar një barrë të rëndë mbi shoqërinë kosovare.³ Një folës ka thënë se e gjithë qeveria e Kosovës karakterizohet nga një aleancë mes elitave politike e biznesore të shprehur në “marrëdhënie mes privilegjmarësit dhe privilegjdhënësit”. Disa nga biznesmenët kryesorë janë poashtu në politikë, përfshirë deputetë dhe ministra. Disa folës frigohen se vazhdimi i këtij procesi të pakontrolluar mund ta përmbysë procesin demokratik të paslusftës.

³ Pjesa më e madhe e kompanive mbështeten në privilegjet e qeverisë dhe në tenderë, të cilat sipas raporteve të ndryshme, përcjellen me parregullshi të mëdha. Shume thonë se rreth 20 përqind e buxhetit publik shpenzohet në kërkimin e qerasë në sektorin publik.

Partitë politike dhe biznesmenët kanë një marrëdhënie reciproke. Partitë llogarisin në politikanët për mbështetje financiare, siç është financimi fushatave elektorale, kurse biznesmenët mbështeten tek zyrtarët e fuqishëm partiakë e qeveritarë për favore dhe qasje të privilegjuar në resurset ekonomike. Përfaqësuesit e VV-së lënë të kuptojnë se, në rast se ata janë në krye të qeverisë, disa nga asetet do të riprivatizoheshin, kurse fitimi i pasurisë së re do të bëhej shumë më i vështirë në rast në nuk respektohet ligji. VV-ja nuk është shumë e popullarizuar në mesin e biznesmenëve. Disa nga pjesëmarrësit kanë thënë se disa nga agjencitë dhe rregullatorët kontrollohen nga ata të cilët merren me “blerjen dhe shitjen e aseteve”, duke e bërë kështu të pamundur implementimin e një procesi të drejtë të privatizimit. Transformimi i pronës publike në pronë private ka qenë një nga sfidat kryesore për ndërtimin institucional, si dhe një mundësi shumë e mirë për korrupsion masiv në Kosovë. Shumë nga pjesëmarrësit e kanë konsideruar si të dyshimtë vetëvrastjen e ish-kryesuesit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit i cili, siç është raportuar zyrtarisht, kishte therrë veten më shumë se 12 herë.

Përfaqësuesit e VV-së kanë thënë se marrëdhëniet mes shtetit dhe shoqërisë duhet të ristrukturohen, me qëllim të dobësimit të elitave politike e ekonomike, dhe fuqizimit të shoqërisë dhe institucioneve. Në këtë kontekst, VV-ja propozon ndryshimin e tërësishtëm të sistemit tatimor - hyrja në fuqi e tatimit progresiv ku të pasurit do të paguanin më shumë - dhe miratimin e politikave të cilat nxisin prodhimin, dhe kështu e transformojnë shoqërinë kosovare nga një shoqëri konsumuese në shoqëri prodhuese, kurse ndërmarrjet nga privilegjimarrës, në ndërmarrje të prodhues.

Përfaqësuesit e VV-së thonë se partia e tyre është më së miri e pozicionuar për të udhëhequr një proces të tillë, duke shtuar se ata tashmë e kanë dëshmuar në Prishtinë, aty ku VV-ja ka kryetarin e komunës, se ata mund të përplasen me të fuqishmit dhe të korruptuarit. Autoritetet komunale të Prishtinës kanë ndaluar biznesin e ndërtimeve ilegale, biznes ky i cili sipas njërit nga folësit, udhëhiqet nga më të fuqishmit, përfshirë këtu edhe vëllaun e Presidentit Hashim Thaci. Folësit janë pajtuar se VV-ja ka inicuar një debat të gjallë, edhe pse nodshita paksa kontraverz, në lidhje me drejtimin të cilin do ta merr në të ardhmen shteti. Megjithatë, çdo partië i duhet fuqia e pushtetit në mënyrë që idetë të përkthehen në aktivitete politike. “VV-ja është shumë idealiste për rrethanat ku jemi”, ka thënë njëri nga pjesëmarrësit. Shumë nga ta kanë thënë se VV-ja nuk do të jetë në gjendje ta fitojë pushtetin pa “sjellur idealet dhe principet e tyre më afër realitetit të Kosovës”.

Skepticizmi serb ndaj Lëvizjes Vetëvendosje

Serbët kanë pothuajse të njejtat brenga sikurse ato të VV-së në lidhje me kapjen e shtetit, korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ata kanë konfirmuar se komuniteti serb është dobësuar edhe më shumë politikisht dhe ekonomikisht - shumë më shumë se sa komuniteti shqiptar. Ata poashtu kanë bërë të ditur faktin se ata nuk kanë fuqi t'i kundërvihen politikanëve të fuqishëm në Prishtinë apo Beograd, posaçërisht kur një numër i madh i serbëve varen nga Beogradi për të ruajtur vendet e tyre të punës dhe pagat, njësoj sikurse që shqiptarët varen nga lidhjet partiake për të ruajtur vendet e tyre të punës. Serbët ballafaqohen me po të njejtat sfida politike. Edhe pse kanë zgjedhje, përfaqësuesit e tyre “zgjedhen” nga zyrtarët në Beograd, e jo nga votuesit në Kosovë. Me të marrë një pozitë pune, atëherë duhet të tregosh lojalitetin ndaj partisë me qëllim të ruajtjes së vendit të punës. Profesionalizmi nuk është standard i cili kërkohet për punë në

sektorin publik. Për më shumë, profesionalizmi nuk është as aset. Politikanët ua kanë frikën profesionistëve dhe individëve me integritet.

Përkundër faktit se shumë nga brengat i kanë të përbashkëta, serbët janë skeptik në lidhje me veprimet dhe ideologjinë e VV-së. Ata thonë se VV-ja shumë shpesh ka kontribuar në ngritjen e tensioneve mes serbëve dhe shqiptarëve, duke u fokusuar në mënyrë të pabarabartë në çështje të karakterit etnik. Retorika publike e VV-së dhe disa nga metodat e tyre janë ekstreme. Ata kanë përdorur dhunë në protestat kundër ish-ministrit Aleksandar Jabllanoviq për shkak se ai i kishte quajtur nënat e personave të zhdukur “egërsira”. Megjithatë, ata nuk kanë reaguar aspak kur një bisedë e përgjuar telefonike ka zbuluar se kryeministri i atëhershëm, Hashim Thaçi, u ishte referuar banorëve të Malishevës si “zagarë”. Për më shumë, veprimet dhe deklaratat e tyre kundër Asociacionit/Komunitetit janë shumë më të fuqishme se sa ato kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe pse këto dy të fundit paraqesin kërcënim më të madh për të ardhmen e Kosovës. Si rezultat i kësaj, serbët e konsiderojnë VV-në pikësëpari si parti antiserbe. Një perceptim i tillë mund të ekzistojë pjesërisht për shkak se serbët nuk janë të njohur me ideologjinë e përgjithshme dhe aksionet e VV-së, por një perceptim i tillë ekziston kryesisht për shkak të mënyrës se si VV-ja e prezenton veten përmes veprimeve ekstreme kundrejt serbëve.

Përfaqësuesit e VV kanë mohuar se veprimet e tyre janë kundër serbëve të Kosovës, duke thënë se ata kanë problem me Beogradin, e jo me serbët e Kosovës. Ata kanë pranuar se shpeshherë nevojiten masa ekstreme për ta kundërshtuar fushatën ekstreme të Beogradit për ta minuar Kosovën nga brenda, përmes krijimit të organeve të kontrolluara ekskluzivisht nga Beogradi, siç është rasti i Asociacionit/Komunitetit, dhe në fushën ndërkombëtare, përmes lobimit intenziv që bëhet me qëllim të pengimit të Kosovës në përpjekjet e saja për t’iu bashkuar institucioneve ndërkombëtare, siç është UNESCO. Ata poashtu kanë shpjeguar se asnjë nga veprimet e tyre nuk janë kundër komunitetit serb, por kundër politikave të qeverisë dhe zyrtarëve publik. Zemërimi për deklaratën e Aleksandar Jabllanoviqit është shprehur në sheshin kryesor në Prishtinë, e jo në fshatrat serbe, sikur në vitin 2004.

Serbët janë të brengosur jo vetëm me retorikën e VV-së, por edhe me qëndrimet e tyre politike rreth decentralizimit, ulëseve të rezervuara, shumicës së dyfishtë, dhe aspekteve tjera të veprimit afirmativ. Përfaqësuesit e VV-së shpeshherë kanë thënë se nëqoftëse janë në pushtet, ata do t’i heqin benefitet e këtij “diskriminimi pozitiv”. Serbët thonë se VV-ja duhet në mënyrë shumë të drejtpërdrejt të tregojnë nëse ata i respektojnë këto të drejta të serbëve. Nëse jo, serbët do të vazhdojnë të kenë dyshime rreth VV-së.

Përfaqësuesit e VV-së kanë ofruar një shpjegim. Ata kanë thënë se barazia është principi udhëzues i VV-së në ndërtimin e demokracisë qytetare dhe shtetit, por kanë thënë se grupet e rrezikuara mund të kenë nevojë për mekanizma shtesë me qëllim të garantimit të mundësive të barabarta brenda sistemit. Megjithatë, kërkesat për mekanizma të tillë shtesë duhet të vijnë nga vetë komuniteti, e jo nga Beogradi. “Ne nuk kemi problem me kërkesën, por me parashtruesin e kërkesës”. VV-ja nuk do të kishte problem me Asociacionin/Komunitetin sikur ai të ishte propozuar nga serbët e Kosovës, por nuk do të pajtohet me krijimin e mekanizmave të cilët kërkohen një shtet tjetër dhe i shërbejnë atij shteti, e jo nga komuniteti në Kosovë. Përfaqësuesit e VV-së kanë konfirmuar se ata do të vazhdojnë ta kundërshtojnë krijimin e Asociacionit/Komunitetit, por mbeten të hapur për diskutime me serbët e Kosovës rreth nevojave

të tyre. VV-ja do t'i përgjigjej pozitivisht kërkesave dhe nevojave të serbëve të Kosovës, por do të kundërshtonte fuqishëm kërkesat e Beogradit. Ata kanë thënë se kryeministri serb Aleksandar Vuçiq nuk ka qëllime të mira për Kosovën, dhe se plani i tij për krijimin e Asociacionit/Komunitetit nuk ka për qëllim fuqizimin e komunitetit serb në Kosovë, por krijimin e një Serbie të vogël në Kosovë.

Serbët e Kosovës besojnë së frika e VV-së në lidhje me Asociacionin/Komunitetin dhe ndikimi i Beogradit janë të ekzagjeruara. Një komunitet prej 5 përqind , i dobët politikisht dhe ekonomikisht, nuk mund ta minojë shumicën dërrmuese. Ata u kanë bërë ftesë përfaqësuesve të VV-së të kenë diskutime të drejtpërdrejta rreth asaj se pse u duhet Asociacioni/Komuniteti dhe të gjejnë qasje të cilat adresojnë frikat e të dyja palëve. Serbët janë pajtuar se çështjet janë politizuar së tepërmi, ende para se të qitet çkado në letër. Asociacioni/Komuniteti tashmë është karakterizuar si Republika Srpska, kali i Trojës, dhe si shtet brenda shtetit, edhe pse Asociacioni/Komuniteti ende nuk ka statut.

Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë është një tjetër pozicion i VV-së i cili i shqetëson serbët e Kosovës. Ata besojnë se në një skenar të tillë, serbët do të shëndrroheshin në një komunitet të papërfillshëm në një shtet pothuajse tërësisht të pastër shqiptar. Një gjë e tillë do të kishte edhe pasoja rajonale, sidomos për Bosnje e Hercegovinën dhe Maqedoninë. Përfaqësuesit e VV-së kanë thënë se qasja e tyre përfshin vetëm mjete paqësore. “Nëse nuk ka mundësi të bashkohemi në mënyrë paqësore, atëherë ne vazhdojmë si Kosovë”.

Në përgjithësi, perceptimet e serbëve karshi VV-së janë të përziara. Shumë nga ta besojnë se me ardhjen në pushtet të VV-së, problemet e serbëve të Kosovës do të adresoheshin në mënyrë të sigurtë, por nuk janë të sigurtë nëse zgjidhjet e ofruara do ta kënaqnin komunitetin serb. Edhe pse përfaqësuesit e VV-së kanë ritheksuar se ata janë kundër ndërhyrjes së Beogradit në punët e brendshme të Kosovës, e jo kundër serbëve të Kosovës, shumë nga serbët janë ende skeptik. Gjithashtu, edhe pse jo tërësisht, shumica e serbëve thonë se pjesa më e madhe e pozicioneve të Beogradit rreth Kosovës reflektojnë interesat e komunitetit serb, dhe së këndejmi, të jesh kundër pozicioneve të Beogradit do të thotë të jesh edhe kundër interesave të serbëve të Kosovës. Pjesa dërrmuese e komunitetit serb e sheh VV-në ai një organizatë ekstreme. Përfaqësuesit e VV-së kanë thënë se ndonjëherë, ata mund të mos kenë qenë mjaftueshëm të kujdesshëm me deklaratat e tyre, por se do të sigurohen që mesazhi i tyre i vërtetë të shpërndalet. Ata poashtu kanë premtuar se do ta përkthejnë programin e tyre partiak në gjuhën serbe.

Përfundimet

Si shqiptarët, ashtu edhe serbët, vuajnë nga shtypja politike dhe ekonomike. Si politika, ashtu edhe aktiviteti ekonomik janë monopolizuar dhe kontrollohen nga një grup i vogël njerëzish. Vetëm zhvillimi ekonomik, së bashku me drejtësinë sociale do ta çlironte shoqërinë nga kjo kapje e shtetit. Bashkëpunimi mes serbëve e shqiptarëve rreth çështjeve praktike është thelbësor për fuqizimin e shoqërisë në përgjithësi. “Ne duhet të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin, e jo thjesht ta tolerojmë njëri-tjetrin”. Toleranca ka konotacion negativ, dhe nënkupton se komuniteti tjetër është i keq, por ju lutem tolerojini. Bashkëpunimi socio-ekonomik dhe zhvillimi neutralizojnë problemet etnike dhe ato të identitetit.

Integrimi politik pa integrim shoqëror dhe ekonomik është i pamjaftueshëm, sepse përderisa e para ndodhë në zyra të rehatshme të qeverisë mes politikanësh kryesisht të korruptuar, e dyta ndodhë në fabrika dhe universitete mes njerëzve të cilët sigurojnë jetesën përmes punës së palodhshme. Për të promovuar integrimin shoqëror nevojitet një dialog nga poshte lart, si dhe një bashkëpunim rreth çështjeve praktike, siç janë bujqësia, mjedisi, qasja në tregje dhe arsimiti, ku serbët e shqiptarët marrin pjesë si individë në kapacitetin e tyre qytetar, e jo në ate etnik. Interesi i përbashkët në këto çështje është më i fuqishëm se identiteti.

Një komunikim më i shpeshtë dhe më thelbësor mes VV-së dhe serbëve do të kontribuonte në rritjen e mirëkuptimit të pozicioneve të secilës palë. “Ne ende mund të mos pajtohemi, por së paku do të kemi një ide më të qartë në lidhje me ate se për çfarë nuk po pajtohemi”. VV-ja ka konfirmuar se dëshiron ta forcojë bashkëpunimin me serbët e Kosovës, por se do të vazhdojë t’i kundërshtojë politikat e Beogradit. “VV-ja ka nevojë për partnerë nga komuniteti serb, e jo për zëdhënës të Beogradit”. Përfaqësuesit e VV-së kanë thënë se shumica e karakterizimeve të saj si parti ekstreme janë thjesht portretizime të mediave të kontrolluara nga qeveria, dhe kanë thënë se shpresojnë që një komunikim i drejtpërdrejt do t’i qartësonte këto portretizime të bëra nga ana e mediave. Serbët e Kosovës, në anën tjetër, do të duhej të jenë më aktiv në sferën politike dhe shoqërore, duke ndërmarrë më shumë iniciativa të përgatitura nga vetë ata, përfshirë edhe krijimin e një partie të pavarur të serbëve të Kosovës.

Qasja ndaj integritit duhet të ndryshojë. Integrim ndëretnik nuk duhet të jetë qëllim, por pasojë e integritit ekonomik e social, dhe së këndejmi, fokusi duhet të vihet tek kjo e dyta. Parakusht për këtë lloj integrimi është politika autentike dhe e pavarur e cila bazohet në koncepte, e jo në individë. Por, komuniteti ndërkombëtar dhe qeveritë në Prishtinë e Beograd kanë përjashtuar autentikën dhe të pavarurën nga procesi, kryesisht për shkak se ato, për ndryshim nga “politikanët e korruptuar”, nuk ofrojnë “zgjidhje të lehta dhe të shpejta”. Marrëdhëniet ndëretnike duhet të bazohen në bashkëpunimin qytetar, duke e bërë kështu gradualisht identifikimin në baza etnike jorelevant.

Pjesëmarrësit

Milica Andric, Menaxhere e projektit, OJQ Aktiv
Aida Derguti, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Dukagjin Gorani, Anëtar, Lëvizja Vetëvendosje
Fatmire Kollcaku-Mullhaxha, Nënkryetare, Lëvizja Vetëvendosje
Dragisa Krstovic, Ish-anëtar, Parlamenti i Kosovës
Albin Kurti, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Petar Miletic, Ish-nënkryetar, Parlamenti i Kosovës
Miodrag Milicevic, Drejtor ekzekutiv, OJQ Aktiv
Dusan Radakovic, Drejtor, Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike
Nenad Radosavljevic, Drejtor, RTV Mir
Zivojin Rakocevic, Drejtor, Qendra e Kulturës, Graçanicë
Naim Rashiti, Drejtor ekzekutiv, Grupi i Ballkanit për Hulumtim të Politikave
Besa Shahini, Analiste e pavarur
Sanja Sovrlić, Gazetare, RTV Mir
Rada Trajkovic, Ish-anëtare, Parlamenti i Kosovës
Shpetim Gashi, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Arber Kuci, Përfaqësues në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Krystyna Marty Lang, Ambasadore e Zvicrës në Kosovë
Saskia Salzmann, Këshilltare Rajonale e Sigurisë Njerëzore, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës
Roland Salvisberg, Kryesues, Politika e Paqes, Divizioni i Sigurisë Njerëzore, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës
Talia Wohl, Zyrtare e Programit, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës